

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa, si kryetare e kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer, si Gjyqtar raportues dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Valdete Daka si anëtare e kolegjit, të ndihmuar nga Këshilltari ligjor i EULEX-it Adnan Isufi, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale të Gjykatës Themelore të Prishtinës, PPRKR 347/13, kundër të pandehurit:

AM

[REDACTED], në paraburgim prej 5 nëntorit 2013.

I akuzuar për kryerjen e veprave penale përgatitje e veprave terroriste në bashkëkryerje në shkelje të nenit 144 paragrafëve 1 dhe 2, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, pjesëmarrje në grup terrorist në shkelje të nenit 143 paragrafit 2 në lidhje me nenin 135 paragrafin 4 të KPK-së, Posedim i kundërligjshëm dhe mbajtja e më tepër se katër armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit 2 të KPK-së, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në shkelje të nenit 147 paragrafit 1 të KPK-së.

LP

AM

Duke vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të pandehurit [REDACTED] kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PPRKR nr. 347/13 (PPS: 94/2013) të datës 25 shkurt 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. 350/2015 të datës 6 mars 2015.

Pas shqyrtimit të mendimit të Prokurorisë së Shtetit të dorëzuar më 17 prill 2015, sipas Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), gjykata pas këshillimit lidhur me çështjen të mbajtur më 12 maj 2015, lëshon këtë:

Aktgjykim

AM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të pandehurit [REDACTED] kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PPRKR nr. 347/13 (PPS: 94/2013) të datës 25 shkurt 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. 350/2015 të datës 6 mars 2015, refuzohet si e pabazuar.


LP

AM

Arsyetim

I. Historia e procedurës

I pandehuri [REDACTED] dyshohet për kryerjen e veprave penale Përgatitje e veprave terroriste në bashkëkryerje në shkelje të nenit 144 paragrafëve 1 dhe 2, në



lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Pjesëmarrje në grup terrorist në shkelje të nenit 143 paragrafit 2 në lidhje me nenin 135 paragrafin 4 të KPK-së, Posedim i kundërligjshëm dhe mbajtja e më tepër se katër armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit 2 të KPK-së, Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në shkelje të nenit 147 paragrafit 1 të KPK-së

Më 5 nëntor 2013, i pandehuri [REDACTED] (AM) është arrestuar së bashku me të dyshuarit e tjerë, dhe pas kërkeses së prokurorit të paraqitur më 7 nëntor 2013, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore të Prishtinës ka lëshuar aktvendimin mbi caktimin e paraburgimit kundër të pandehurve, përfshirë të pandehurin i cili i nënshtrohet procedurës penale aktuale. Që nga atëherë, gjykatat kanë shqyrtuar disa herë dhe vazhduar paraburgimin kundër [REDACTED] (AM)

Më 23 janar 2015, prokurori ka ngritur aktakuzën në këtë lëndë penale dhe shqyrtimi fillestar është mbajtur më 11 shkurt 2015. (AM)

Më 23 shkurt 2015, kryetari i trupit gjykues ka lëshuar aktvendimin mbi vazhdimin masës së paraburgimit kundër të pandehurit [REDACTED] deri më 23 prill 2015.

Më 24 shkurt 2015, aktvendimi i lartpërmendur është ankimuar nga të pandehurit, përfshirë të pandehurin [REDACTED] (AM)

Më 6 mars 2015, Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesat si të pabazuara dhe ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar të kryetarit të trupit gjykues të datës 23 shkurt 2015. (LP)

Më 30 mars 2015, avokati mbrojtës [REDACTED] (AM) në emër të pandehurit [REDACTED] ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës kundër aktvendimeve të lartpërmendura të lëshuara nga gjykata e shkallës së parë dhe dytë.

## II. Parashtrësat e palëve

Avokati mbrojtës ka bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në shkeljen substanciale të dispozitave të procedurës penale. Në kërkesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar autorizimet e saj ligjore të përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas avokatit mbrojtës, aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit mund të lëshohet vetëm pas kërkesës me shkrim nga prokurori, e cila në këtë rast nuk ekziston.

Avokati mbrojtës thekson se aktvendimet e ankimuara nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme, qarta dhe bindëse në lidhje me dyshimin e bazuar. Sipas avokatit mbrojtës, gjykatat kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë pasi që aktakuza ende nuk është konfirmuar. Avokati mbrojtës pretendon se me vazhdimin e paraburgimit, gjykatat jo vetëm që kanë paragjykuar gjendjen faktike por gjithashtu kanë bërë shkelje të të drejtave të pandehurit që të konsiderohet i pafajshëm deri në marrjen e aktgjykimit të formës së prerë.

Avokati mbrojtës po ashtu i konteston edhe gjetjet e tjera të gjykatës sa i përket rrezikut të arratisjes, rrezikut të pengimit të procedurës penale dhe/ose rrezikut të kryerjes së veprave të tjera penale. Avokati mbrojtës pohon se gjykata më të ulëta kanë vërtetuar gabimisht se ekziston rreziku i arratisjes duke u mbështetur vetëm në

kohëzgjatjen e dënimit dhe në peshën e veprave penale. Sa i përket rrezikut të pengimit të procedurës penale, avokati mbrojtës argumenton se prokuroria nuk ka paraqitur asnjë palë apo dëshmitar që në këtë rast do të mund të ndikoheshin nga i pandehuri. Përveç kësaj, avokati mbrojtës parashton se provat materiale tanimë janë siguruar prandaj nuk ekziston asnjë rrezik që i pandehuri të ketë çfarëdolloj qasje fizike në ato prova. Për më shumë, avokati mbrojtës argumenton se nuk ekziston asnjë argument që do të dëshmonte se nëse i pandehuri do të mbrohej në liri, do të kryente vepër tjetër penale.

Avokati mbrojtës propozon që gjykata t'i ndryshojë aktvendimet e apeluara, ta lirojë të pandehurin nga paraburgimi ose ta zëvendësojë masën e paraburgimit me ndonjë masë alternative nga KPP-ja.

Më 17 prill 2015, Zyra e prokurorit të Shtetit të Kosovës në përgjigjen e vet KMLP II-ZZZK II nr.17/15, propozon që gjykata ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, dhe t'i vërtetojë aktvendimet e kundërshtuara në tërësi.

### III. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

- Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme; është paraqitur nga personi i autorizuar brenda afatit ligjor.
- Gjykata Supreme e Kosovës, megjithatë gjen se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

### IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata është e kënaqur që gjykatat e instancave paraprake kanë vlerësuar saktë, plotësisht dhe drejt se ekzistojnë baza për vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit [REDACTED] Sa i përket mungesës së dyshimit të bazuar dhe pretendimit se nuk ka kërkesë me shkrim nga prokurori, Gjykata konsideron se ky argument nuk është meritör. Siç është evidentuar në shkresa të lëndës – që faktikisht nuk kundërshtohet as nga mbrojtja – prokurori ka kërkuar vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit gjatë seancës së datës 11 shkurt 2015. Nuk është kontestuese se edhe avokati mbrojtës ka pasur mundësi ta kundërshtojë atë. Gjykata vëren se me nenin 191 të KPP-së nuk kërkohet të ketë kërkesë me shkrim nga prokurori për vazhdimin e paraburgimit, siç pretendon avokati mbrojtës. Kërkesa me shkrim kërkohet vetëm kur paraburgimi fillimisht caktohet në përputhje me nenin 188 të KPP-së. Ko është e saktë, sepse në këtë situatë gjykata duhet të vërtetojë dyshimin e bazuar dhe të ofrojë arsyetim adekuat se janë plotësuar kushtet e tjera specifike të parapara me nenin 187 të KPP-së. Sa i përket vazhdimin të paraburgimit, sikurse në rastin tonë, gjykata vetëm vlerëson nëse ka ndonjë ndryshim të rrethanave të vërtetuara më parë. Në rastit konkret, avokati mbrojtës nuk ka paraqitur fakte dhe/ose prova që japin indikacione për ndonjë ndryshim

thelbësor të rrethanave të vërtetuara më parë. Në kundërshtim me atë që avokati mbrojtës ka argumentuar, Gjykata gjen se fakti që është ngritur aktakuza mjafton për të konstatuar se dyshimi i bazuar ende ekziston. Prandaj, kjo gjykatë është e kënaqur që gjykatat e instancave më të ulëta kanë vlerësuar saktë se nuk ka asnjë ndryshim të rrethanave.

Sa i përket kushteve të tjera specifike, Gjykata është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt rrezikun e arratisjes. Gjykata konsideron se ekziston rreziku i arratisjes, veçmas, duke marrë parasysh rëndësinë e akuzave. Edhe pse nuk është bazë ligjore, fakti se aktakuza tanimë është ngritur paraqet një shtytje e fuqishme që i pandehuri të arratiset.

Sa i përket rrezikut të pengimit të procedurës penale dhe të përsëritjes së veprës penale kolegji vëren se rreziku i pengimit të procedurës penale dhe i përsëritjes së veprës penale nuk mund të kufizohet me ndikimin potencial të dëshmitarëve ose të palës së dëmtuar, siç pretendon avokati mbrojtës. Megjithatë, në çështjen konkrete, kolegji pajtohet me avokatin mbrojtës se këto rreziqe janë zvogëluar pasi hetimi ka përfunduar dhe aktakuza tanimë është ngritur. Megjithatë, Gjykata vëren se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i bazuar vetëm në rrezikun e pengimit të provave. Prandaj, ky fakt nuk ka pasoja sa i përket masës së shqiptuar.

Gjykata është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë ka marrë mjaftueshëm parasysh rrethanat individuale të të pandehurit kur ka bërë vazhdimin e paraburgimit i cili është i domosdoshëm për eliminimin e rreziqeve të vërtetuara. Gjykata është e mendimit se ndryshimi i masës së shqiptuar ndaj të pandehurit në këtë fazë të procedurës qartazi do të ishte pavend. Masa e shqiptuar nuk përbën asnjë shkelje të parimit të proporcionalitetit.

## V. Përfundimi

Për këto arsye, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA SURPEME E KOSOVËS PML-KZZ-84/2015, data 12 maj 2015

Kryetare e kolegjit:

Procesmbajtës:

Emine Mustafa,

Adnan Isufi, Këshilltar ligjor

Anëtarë të kolegjit

Willem Brouwer,  
Gjyqtar i EULEX-it



Republika e Kosovës

Valdete Daka

Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Gjykatës Supreme

SAKTËSINË E KOPËNËS  
TACNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar  
laščeni radnik

*[Signature]*

faqe 4 prej 4